



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT DURRES

ANALIZA VJETORE

e

Prokurorisë Apelit Durrës për vitin 2019


Në përmbushje të detyrave të ngarkuara përmes Tuajës nr.163 Prot datë 24.01.2020 dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit 97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhëri nr. 330/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, parashtroj në mënyrë të përmbledhur përpara Prokurorit të Përgjithshëm treguesit e përgjithshëm të punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë Apelit Durrës dhe në mënyrë të veçantë të prokurorëve pranë kësaj prokurorie, gjatë vitit 2019.

Në vitin 2019 rezulton se janë regjistruar 1075 çështje penale, nga këto 718 çështje me objekt themel/karakter administrativo penal dhe 357 çështje me objekt masa sigurimi. Gjykuar dhe arshivuar në vitin 2019 gjithsej janë 1093 çështje penale ku 44¹ çështje ishin të mbartura nga viti 2018.

Çështjet e gjykuara dhe te përfunduara gjatë vitit 2019 janë: 1093 çështje gjithsej. Nga këto 410 çështje janë me objekt themel që i përkasin fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës së dënimit dhe alternativave të dënimit, 332 çështje janë me karakter administrativo penal (kërkesa prokurori për pushim çështje për kundërvajtjet penale, dërgim çështje në gjyq, kundërshtim të vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimeve, njohje vendimi penal të juaj, ekstradime lirim me kusht, etj) dhe 351 çështje janë me objekt vlefësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi.

Treguesit analitikë sipas llojit të veprave penale dhe rretheve gjyqësore, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Viti 2019	Durrës	Elbasan	Kavajë	Gjithsej
krimet kunder jetës dhe shëndetit, nenet 76-83 k.p.	5	2	0	7
kundravajtjet penale ndaj shëndetit, nenet 84 -90	6	8	3	17
krimet seksuale, nenet 100-108 k.p.	3	1	0	4
krimet kundër lirisë, moralit dhe familjes, nenet 109-130/a k.p.	34	40	8	82
krimet kundër pasurisë dhe sferën ekonomike, nenet 134-162 k.p.	46	22	7	75



krimet në fushën e doganave dhe tatimeve, nenet 171-182 k.p.	10	1	0	11
krimet e fallsifikimit monedhave e dokumentave, nenet 183-192 k.p.	14	5	0	19
v. penale kundër tokës, mjedisit e ndërtimeve, nenet 199-206 k.p.	12	6	2	20
v. penale kundër veprimtarisë shtetërore, nenet 235-260 k.p.	10	9	4	23
veprat penale rendit dhe sigurisë publike, nenet 261-293 k.p.	35	31	10	76
veprat penale kundër drejtësisë, nenet 300-324 k.p.	6	4	1	11

Referuar llojit të veprave penale, rezulton se veprat penale kundër lirisë, moralit dhe familjes¹, zenë numrin më të madh të çështjeve që janë bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Durrës me 82 çështje, që pasohet nga veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike² me 76 çështje, si dhe krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike³ me 75 çështje të gjykuara. Pra, krahasuar me vitin 2018 vihet re një rritje e lehtë e veprave penale kundër lirisë, moralit dhe familjes dhe një ulje prej 41 çështjesh për krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Ndërsa veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike kanë pësuar një rënie prej 50% krahasuar me vitin 2018.

Të dhënat e çështjeve të përfunduara krahasimisht në vitet 2018 dhe 2019, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme:


Gjykime të përfunduara gjatë vitit 2018

2018	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk. themeli	525	284	176	65
Masa sigurimi	269	141	93	35
Lirim me kusht	25	5	13	7
Gjykime tjera	269	129	110	30
Totali	1088	559	392	137

¹Vepra penale këto të parashikuara nga nenet 109-130/a të k.penal

²Vepra penale këto të parashikuara nga nenet 261-293 të k.penal

³ Vepra penale të parashikuara nga nenet 134-162 të k.penal



Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2019

2019	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk. themeli	410	213	150	47
Masa sigurimi	351	181	129	41
Lirim me kusht	29	9	15	5
Gjykim të tjera	303	129	130	44
Totali	1093	532	424	137

Në vitin 2019, ka përfunduar gjykimi për 1093 çështje penale, në një kohë që në vitin 2018 janë përfunduar 1088 çështje penale.

Nga 1093 çështje të përfunduara në Gjykatën e Apelit Durrës gjatë vitit 2019, të ndara sipas objektit të gjykimit rezultojnë se: është përfunduar gjykimi për: 410 çështje janë me objekt themel (që i përkasin fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativave të dënimit), 332 çështje janë me karakter administrativo penal (kërkesa prokurori për pushim çështje për kundërvajtjet penale, dërgim çështje në gjyq, kundërshtim të vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimeve, njohje vendimi penal të huaj, ekstradime lirim me kusht etj) dhe 351 çështje janë me objekt vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi.

Nuk ka përfunduar gjykimi për 63 çështje themeli/administrativo penale të cilat kryesisht ishin planifikuar për gjykim në nëntor/dhjetor 2019 dhe 6 çështje me objekt Masë Sigurimi.

Çështjet e përfunduara në vitin 2019, sipas rretheve gjyqësore, rezultojnë se: 532 çështje i përkasin rrethit gjyqësor Durrës, 424 çështje rrethit gjyqësor Elbasan dhe 137 rrethit gjyqësor Kavajë.

Treguesit analitikë sipas rretheve gjyqësore, sipas objektit gjykimit, dhe subjektit ankimes, krahasuar me vitin 2018, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme:

Çështjet të përfunduara gjatë vitit 2018

2018	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk themeli e objek tjera	819	418	299	102
Masa sigurimi	269	141	93	35
Ankim Pandehuri	759	355	287	117
Ankim Prokurori	205	132	61	12
I dëmtuari	63	34	22	7
Ankim Prok./Pand.etj.	60	37	22	1
Totali	1088	559	392	137

ÇËSHJET E GJYKUARA GJATË VITIT 2019

2019	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk themeli e objekte te tjera	742	360	289	93
Gjykimi i ceshtjeve me objekt: <u>Masa sigurimi</u>	351	172	135	44
TOTAL	1093	532	424	137

Të dhënat e ankimeve të ushtruara në total për vitin 2019, sipas ankuesit paraqiten të detajuara në tabelën e mëposhtme:

2019 ANKIMET	I pandehuri/i dyshtuar	Prokurori	Prok./Pand.etj.	TOTAL
Gjyk Themeli e objekte te tjera	550	168	24	742
Gjyk. Masa sigurimi	292	55	4	351
Total	842	223	28	1093

E zberthyer sipas objektit te gjykimit, sipas ankuesit dhe rretheve, paraqitet si më poshtë vijon:

2019	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk <u>Themeli</u> e objekte te tjera	742	360	289	93
Ankim pandehuri/persona nën hetim/ i demtuari	550	250	222	78
Ankim Prokurori	168	101	54	13
Ankim Prok./Pand.etj.	24	9	13	2

2019	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjykimi i çeshtjeve me objekt: Masa sigurimi	351	172	135	44
Ankim i Pandehuri/persona nën hetim/ i demtuari	292	145	106	41
Ankim Prokurori	55	26	26	3
Ankim Prok./Pand.etj.	4	1	3	0


Numri i çeshtjeve të ardhura mbi ankimin e prokurorit dhe prokuror/I pandehur gjatë vitit 2019, paraqitet si më poshtë:

2019	Themel	Masa sigurimi	Total
Ankim Prokurori	168	55	223
Ankim Prok./Pand.etj.	24	4	28
TOTAL			251

Rezultoni se prokurorët e rrethit gjyqësor Durrës, Elbasan, Kavajë kanë ushtruar gjithsej 223 ankime ndaj vendimeve të gjykatës së faktit, të ndara sipas rretheve: 127 ankime ndaj vendimeve të gjykatës faktit Durrës, 80 ankime ndaj vendimeve të gjykatës rrethit gjyqësor Elbasan, 16 ankime ndaj vendimeve të gjykatës rrethit gjyqësor Kavajë. Por duke mbajtur në konsideratë edhe çeshtjet e ardhura mbi ankimin e prokurorit dhe i pandehur, rezultoni se numri total i ankimeve të prokurorit është 251. Krahasuar kjo shifër me atë të vitit 2018, rezultoni se jemi në situatë të përafërt.

Çeshtje me objekt gjykimin e themelit/administrativo penale; Ka përfunduar gjykimi i çeshtjeve objekt themel/administrativo penal, gjithsej 742 çeshtje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 360 rrethit gjyqësor Durrës, 283 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 93 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto çeshtje, rezultoni se në 550 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve/demtuari/ankues dhe 168 raste mbi ankimin e prokurorit, 24 çeshtje me ankim Prok./Pandehur. Por, duke mbajtur në konsideratë dhe 24 çeshtjet e ardhura mbi ankimin e prokuror/i pandehur, rezultoni se numri total i ankimeve të prokurorit është 192.

Çeshtje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi: Ka përfunduar gjykimi i çeshtjeve objekt vleftësim, caktim apo zëvendësim mase sigurimi, gjithsej 351 çeshtje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 181 rrethit gjyqësor Durrës, 129 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 41 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto çeshtje rezultoni se në 292 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar



në shkallë të dytë mbi ankimin e të personave nën hetim/mbrojtësve, 55 raste mbi ankimin e prokurorëve, 4 çështje me ankim Prok/person nën hetim. Por, duke mbajtur në konsideratë 4 çështjet e ardhura mbi ankimin e prokuror/i pandehur, rezulton se numri total i ankimeve të prokurorit është 59.

Nga këta tregues rezulton se nga 1093 çështje të gjykuara në vitin 2019, 251 çështje kanë ardhur mbi ankim prokurori dhe prokuror/i pandehur, pra gati 1/5 e ankimeve janë ushtruar nga prokurorët.


Për rrethin gjyqësor Durrës, rezulton se janë gjykuar gjithsej 532 çështje penale, nga të cilat 360 çështje janë me objekt themeli /administrative penale dhe 172 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Nga raporti si subjekte ankuese rezulton se: nga të pandehurit, të dëmtuarit, personat nën hetim, është ushtruar ankim në 395 raste(përkatësisht 250 ankime për çështjet me objekt themel/ administrative penale dhe 145 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi). Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në 127 raste(përkatësisht 101 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale dhe 26 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi). Ne 10 raste me ankim prok/pandehuri(përkatësisht 9 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale dhe 1 ankim për çështjet me objekt masa sigurimi). Por, duke mbajtur në konsideratë 10 çështjet e ardhura mbi ankimin e prokuror/i pandehur, rezulton se numri total i ankimeve të prokurorit është 137.

Nga treguesit e mësipërm rezulton se pothuajse 50 % e çështjeve i përkasin rrethit gjyqësor Durrës, numri i çështjeve për këtë rreth gjyqësor është i perafërt krahasuar me vitin 2018.

Për rrethin gjyqësor Elbasan rezulton se janë gjykuar gjithsej 424 çështje penale, 289 çështje themeli/administrative penale si dhe 135 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Raporti si subjekte ankuese rezulton se nga të pandehurit/dëmtuar akuzues/persona nën hetim është ushtruar ankim në 328 raste(përkatësisht 222 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale dhe 106 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi), nga ana e prokurorëve në 80 raste (përkatësisht 54 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale dhe 26 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi) dhe 16 raste me ankim prokuror/i pandehur (përkatësisht 13 ankime për çështjet me objekt themel /administrative penale dhe 3 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi). Por, duke mbajtur në konsideratë 16 çështjet e ardhura mbi ankimin e prokuror/ipandehur, rezulton se numri total i ankimeve të prokurorit është 96.

Për çështjet e themeli, administrative penale dhe ato me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi konstatohet se numri i çështjeve të gjykuara në shkallë të dytë për këtë rreth gjyqësor është në rritje.

Për rrethin gjyqësor Kavajë rezulton se janë gjykuar gjithsej 137 çështje penale, nga të cilat: 93 çështje themeli dhe administrative penale si dhe 44 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Nga raporti i subjekteve ankuese rezulton se: nga të pandehurit/dëmtuar akuzues/personat nën hetim është ushtruar ankim në 119 raste(përkatësisht 78 ankime për çështjet me objekt themel dhe administrative penale dhe 41 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi), nga ana e prokurorëve 16 raste (përkatësisht 13 ankime për çështjet me objekt themel dhe administrative penale dhe 3 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi). Me ankim



prokuror/i pandehur 2 raste(me objekt themel). Por, duke mbajtur në konsideratë 2 çështjet e ardhura mbi ankimin e prokuror/i pandehur, rezulton se numri total i ankimeve të prokurorit është 18.

Nga treguesit e mësipërm rezulton numri i çështje të gjykuara gjatë vitit 2019 për këtë rreth gjyqësor është i njëjtë me vitin 2018.

Çështjet e gjykuara mbi ankimin e prokurorit; Gjatë vitit 2019, mbi ankimin e prokurorëve të prokurorive të shkallës parë, janë gjykuar gjithsej 223 çështje nga 205 çështje që janë gjykuar në vitin 2018.

Të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 127, ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 80 ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan, 16 ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorit, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykimit, treguesit paraqiten si më poshtë:

Ankim Prokurori	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
Gjyk themeli Adm.pen.	97	50	11	158
Masa sigurimi	26	26	3	55
Të mbartura nga viti 2018	4	4	2	10
Totali	127	80	16	223

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e te pandehurit, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykimit, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim pandehuri	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
Gjyk themeli Adm.pen.	238	206	73	517
Masa sigurimi	145	106	41	292
Të mbartura nga viti 2018	12	16	5	33
Totali	395	328	119	842

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e Prokurorit/Pandehuri, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykimit, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prokurori/Pandehuri	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
Gjyk. themeli, Administrative penale	9	13	2	28
Masa sigurimi	1	3	0	4
Totali	10	16	2	28

Objekt i ankimeve të ushtruara nga prokurorët e shkallës parë në rreth 76% të çështjeve kanë patur kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të rrethit gjyqësor në lidhje me themelin e çështjeve, për deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit dhënë të pandehurve. Një numër i konsiderueshëm i ankimeve i përket aplikimit të dënimeve alternative të dhënë nga gjykatat e faktit për të cilat prokurorët nuk kanë qenë dakord dhe kanë ushtruar ankim në shkallë të dytë.

Nga ana e prokurorëve të apelit, rezulton se nga 223 raste të ankimuara është përkrahur ankimi në 163 raste. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 9 raste, mospërkrahje ankimi 30 raste që i perkasin kryesisht çështjeve administrativo penale me objekt kundërshtim vendimi pushimi ose mosfillimi procedimi penal. Per keto raste prokurori i apelit nuk e ka përkrahur prokurorin e rrethit pasi ka vlerësuar te drejte vendimin e gjyqes se rrethit per vazhdimin e hetimeve. Ne 8 ceshtje seanca gjyqesore eshte zhvilluar pa pranine e prokurorit ne dhome keshillimi. Për 13 raste është deklaruar heqja dorë nga ankimi prokurorit.

Rastet e heqjes dorë nga ankimi i prokurorëve të shkallës parë, të ndara rrethëve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Hequr dorë nga ankim Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
L. Dodaj	0	4	1	5
M. Duda	0	4	0	4
A. Ndoi	1	0	1	2
F. Elezi	1	1	0	2
Gjithsej	2	9	2	13

Heqjet dorë nga ankimi i prokurorëve. Sikurse rezulton nga treguesit analitikë, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se është deklaruar heqja dorë vetëm në 13 raste nga 223 ankime të ushtruara. Rastet e heqjeve dorë i perkasin 2 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 9 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 2 raste Prokurorisë Rrethit Kavajë. Në përgjithësi rastet e heqjes dorë nga ankimi i perkasin ankimeve për kundërshtimin e aplikimit të dënimeve alternative sipas neneve 59, 63 të k.penal apo për masë dënimi. Në përgjithësi të gjitha rastet heqjeve dorë nga ana e prokurorëve ato janë diskutuar

pararaprisht me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe drejtuesin e prokurorive, vlerësohet se për çdo rast të heqjeve dorë nga ankimi, prokurorët janë bazuar në bindjen e tyre të brendshme si dhe bazuar në kërkesat e ligjit penal material e procedural penal. Për rastet e heqjes dorë nga ankimi, deklarata e heqjes dorë i është dërguar prokurorëve përkatës pranë prokurive të rrethve gjyqësore.

Duke mbajtur në konsideratë 30 raste të mospërkrahjes së ankimit të prokurorëve të rretheve dhe 13 rastet e heqjes dorë nga ankimi i prokurorit, rezulton në total se prokurorët e apelit nuk kanë përkrahur prokurorët e rrethit në 43 raste të cilat kryesisht u përkasin ankimeve të paargumetuara dhe të pa bazuara në prova dhe në ligj. Kjo problematikë është bërë prezente verbalisht prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, pasqyruar në konkluzionet përkatëse të prokurorëve të apelit si dhe deklarata e heqjes dorë u është dërguar prokurorëve përkatës pranë prokurorive të rrethve gjyqësore.

Ankimet e prokurorëve të pranuar nga Gjykata Apelit Durrës.

Sikurse rezulton nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se nga 223 ankime janë përkrahur 182 ankime ose 81%, ndërsa për pjesën tjetër të ankimeve, prokurorët e apelit nuk kanë përkrahur ankimet e prokurorëve, duke e konsideruar të bazuar vendimin e gjykatës së rrethit por dhe nuk është hequr dorë duke i lënë akses gjykimi gjykatës së apelit dhe vetëm në 13 raste është deklaruar heqja dorë nga ankimi prokurorit. Nga 182 rastet e përkrahura të ankimit të prokurorëve rezulton se nga ana e Gjykatës Apelit Durrës, janë pranuar 92 ankime ose në 50% e tyre. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 50 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 33 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 9 ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Nga të dhënat rezulton se përqindja e pranimit të ankimit të prokurorëve të rrethit nga Gjykata e Apelit Durrës, ka një rritje të konsiderueshme nga vitet paraardhëse.

Rastet e ankimeve të pranuar dhe të përkrahura nga gjykata e apelit Durrës, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prokurori i pranuar	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
L. Dodaj	20	14	4	38
M. Duda	17	13	3	33
A.Ndoi	9	5	2	16
F. Elezi	4	1	0	5
Gjithsej	50	33	9	92

Rekurset e ushtruara. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e prokurorëve të apelit në seancë gjyqësore, apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, në mbështetje të parashikimeve të nenit 432 dhe 441 të K.Pr.Penale, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë në 74 raste.

Sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 35 Rekurse janë ushtruar për çështje të rrethit gjyqësor Durrës, 31 Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Elbasan dhe 8 Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Kavajë.

Sipas llojit të çështjeve objekt gjykimi rezulton se janë ushtruar 47 rekurse për çështje themeli, 15 rekurse ndaj vendime me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi dhe 12 rekurse për çështje administrative penale.

Rastet e rekurseve të ushtruara nga secili prokuror të ndara sipas objektit të gjykimit çështjes, treguesit paraqiten si më poshtë:

Rekurset	Çështje themeli	Masa sigurimi	Administrative penale	Gjithsej
L. Dodaj	15	2	1	18
M. Duda	26	10	8	44
A.Ndoi	6	3	3	12
Gjithsej	47	15	12	74

Çështjet me objekt administrativo penal të gjykuara gjatë vitit 2019 paraqiten të grupuara sipas objektit si më poshtë vijon:

Për çështjet penale me objekt lirim me kusht sipas nenit 64 të k.penal. Gjatë vitit 2019 janë bërë objekt gjykimi 29 çështje gjithsej, nga të cilat 9 raste janë të rrethit gjyqësor Durrës, 15 raste janë të rrethit gjyqësor Elbasan dhe 7 raste janë të rrethit gjyqësor Kavajë. Këto çështje, në 10 raste kanë ardhur mbi ankimin e prokurorit ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesat e të dënuarve për lirim me kusht, ndërsa 19 raste kanë ardhur mbi ankimin e të dënuarve.

Nga 10 ankime të prokurorit të rrethit, Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin e prokurorit në 1 rast, në 2 raste të tjera prokurorët e apelit nuk e kanë përkrahur qëndrimin e prokurorit të rrethit duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit, në 1 rast tjetër është vendosur mospranimi i ankimit të prokurorit për shkak heqje dorë nga prokurori i shkallës së parë dhe në 6 raste nuk është pranuar ankimi prokurorit duke pranuar kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht. Për këto raste nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë edhe për faktin se periudha e mbetur e dënimit pa vuajtur ka qenë e shkurtër deri në 1 vit.

Nga 19 raste të ardhura mbi ankimin e të dënuarit, rezulton se nga ana e Gjykatës së Apelit janë pranuar 9 kërkesa duke u liruar me kusht. Nga prokurorët e apelit është ushtruar rekurs në 2 raste, në rastet e tjera nuk është ushtruar rekurs për shkak të kohës së pakët të dënimit të mbetur pa vuajtur. Në 5 raste gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Ndërsa në 5 raste ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak heqje dorë nga ankimi.

Në ankimet e prokurorëve të shkallës parë edhe pse janë përkrahur nga ana jonë, vihet re se nuk bëhet analizë e kërkesave të ligjit si dhe rrethanave dhe sidomos veçorive të dënuarit objekt gjykimi në raport edhe me praktikën gjyqësore të unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të

Gjykatës Lartë me vendimin Nr 2 datë 25.05.2015. Këto mangësi në ankimet e prokurorëve të shkallës parë, janë plotësuar nga ana e prokurorëve të apelit në konkluzionet përkatëse.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.

Gjatë vitit 2019, ka përfunduar gjykimi për 86 çështje me këtë objekt gjykimi. Këto çështje janë bërë objekt gjykimi në shkallë të dytë mbi ankimin e palëve, prokurorit apo personave të interesuar. Për këto çështje duhet të evidentojmë faktin se në disa raste prokurorët e prokurorive të rretheve gjyqësore, gjatë fazës së verifikimit të kallëzimit penal, marrin prova pa u regjistruar procedimi penal, shkak ky që ka shërbyer për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të prokurorit nga gjykata e rrethit dhe e apelit.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për pushimin e procedimit penal.

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 68 çështje me këtë objekt gjykimi. Nga këto një numër i çështjeve kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimit i prokurorit për pushimin e procedimit penal për kundërvajtjet penale, me kërkesat e prokurorit për pushimin e çështjeve në seancë paraprake. Raste të tjera janë ato kur prokurori ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për mungesë provash. Në këtë objekt gjykimi janë vënë re disa problematika ligjore ku gjykatat kanë kthyer aktet prokurorit për hetime të pamjaftueshme duke lënë edhe detyrat përkatëse për plotësimin e hetimeve. Këto raste janë ankimuar nga prokurorët dhe nga prokurorët e apeleve është vlerësuar se në një numër çështjesh vendimet e gjykatës së rrethit kanë qenë të bazuara duke kërkuar lënien në fuqi të tyre. Gjatë periudhës analizuuese, nga ana e prokurorëve të apelit është evidentuar se gjykatat në disa raste kanë pushuar çështjet në seancë paraprake për mungesë provash. Mbi ankimin e prokurorit, këto raste janë përkrahur nga prokurorët e apelit, duke i ndjekur ato edhe me rekurs. Për këto raste, për sa kohë nuk kemi ende praktikë të Gjykatës së Lartë, mbetet në diskutim nëse gjyqtari i seancës paraprake duhet të vendosë pushimin e çështjes për mungesë provash sipas nenit 328/dh të K.Pr.Penale si dhe nëse ekziston e drejta e rekursit pasi ligji nuk e ka parashikuar, por ka parashikuar vetëm të drejtën e apelit.

Çështjet me objekt kërkesë e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq. Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 34 çështje me këtë objekt gjykimi. Këto raste kanë ardhur kryesisht mbi ankimin e prokurorit i cili ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq por gjykata ka vendosur pushimin e çështjes. Këto raste janë përkrahur nga ana e prokurorëve të apelit duke u ndjekur edhe me rekurs në rastet e mospranimit nga gjykata e apelit.

Çështjet me objekt njohje vendimi penal të huaj të gjykara gjatë vitit 2019 janë 7 raste. 3 raste kanë ardhura me ankim prokurori dhe 4 të tjera me ankim të të dënuarit. Nga 3 rastet që i përkasin ankimit të prokurorit, në 2 prej tyre është ankimuar vendimi i gjykatës pjesërisht dhe nga prokurori i apelit nuk është përkrahur prokurori i rrethit, duke u kërkuar lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së rrethit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 68 të K.Penal. Rasti tjetër ka të bëjë me rrëzimin tërësisht të kërkesës së prokurorit nga ana e gjykatës së rrethit, ankim i cili është përkrahur nga prokurori i apelit si dhe është ushtruar rekurs pasi gjykata e apelit nuk e ka përkrahur ankimin e prokurorit.

Çështjet me objekt lejim ekstradimi të gjykara gjatë vitit 2019 janë 8 raste. Të gjitha rastet kanë ardhur në gjykatën e apelit mbi ankimin e personit ndaj të cilit është vendosur ekstradim,

vendime të cilat janë lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit. Në këto çështje janë bërë njoftimet përkatëse Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme brenda afateve të përcaktuara në K.Pr.Penale, duke mos krijuar zvarritje në procedurën e ekstradimit.

Mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Në këtë fazë nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Durrës, është kryer një volum i konsiderueshëm pune, e cila konsiston jo vetëm në bërjen e urdhërave të ekzekutimit, por edhe në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm që i dërgohet prokurorëve të rretheve me qëllim ekzekutimin e vendimeve të gjykatës që nuk janë me ekzekutim të menjëhershëm. Nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit Durrës, janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi të natyrave të ndryshme, urdhëra arrestimi, urdhëra lirimi si dhe urdhëra ekzekutimi për kalimin nga njëra masë sigurimi në një masë tjetër sigurimi. Urdhërat e arrestimit u janë dërguar menjëherë policive gjyqësore të komisariteve përkatëse. Ndërsa urdhërat e lirimit janë ekzekutuar nga sektorët juridik pranë I.E.Vendimeve Penale, bazuar në urdhërat e prokurorit çështjes pranë kësaj prokurorie. Në këto raste është bërë lirimi i menjëhershëm i personave të arrestuar dhe u është njoftuar masë tjetër e sigurimit në rastet kur gjykata ka caktuar masë tjetër sigurimi. Urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë jo vetëm për masat e sigurimit, por edhe për lirimet me kusht si dhe për çështje për të cilat ka përfunduar gjykimi në themel.

Për çështje me objekt gjykimi themeli, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, janë dërguar për ekzekutim praktikantët në prokuroritë e rretheve përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm. Këto praktika janë kryesisht për çështjet e gjykuara në themel, për të cilat është lënë në fuqi vendimi i gjykatës shkallës së parë dhe të pandehurit janë dënuar me burgim, por nuk kanë patur masë sigurimi apo kanë patur masa, të cilat nuk i përgjigjen llojit të dënimit të dhënë, si dhe për gjykimet me objekt lirim me kusht në rastet kur është ndryshuar vendimi dhe është rrëzuar kërkesa e të dënuarit nga gjykata e apelit.

Urdhërat e ekzekutimit të ndara sipas rretheve gjyqësore, paraqiten si vijon:

Urdhëra Ekzekutimi	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
	77	47	22	146

Organizimi, përfaqësimi i akuzës dhe ushtrimin e ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit Durrës.

Organizimi i brendshëm i punës, përfaqësimi i akuzës në gjykim dhe ushtrimin e ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit Durrës, bëhet bazuar në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, si dhe në nenin 42 i ligjit 97/2016 të ndryshuar dhe urdhërat e brendshëm të kësaj prokurorie.

Çështjet e planifikuara për gjykim nga ana e gjykatës apelit Durrës merren nga kryesekretaria e kësaj prokurorie dhe regjistrohet në regjistrin elektronik duke pasqyruar të gjithë treguesit e nevojshëm. Grupimi i dosjeve penale bëhet menjëherë nga drejtuesi i kësaj prokurorie i cili në prani të prokurorëve dhe sekretarisë organizon dhe realizon hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit prokurorët marrin menjëherë dosjet e caktuara me short dhe nga administrata e prokurorisë bëhet fotokopjimi i akteve të nevojshme dhe ja dorëzon ato secilit prokuror.

NGARKESA DHE TREGUESIT E PUNËS PËR SECILIN PROKUROR

Prokurori Ludovik Dodaj. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2019, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 380 çështjeve penale, nga të cilat 22 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2018. Nuk ka përfunduar gjykimin për 18 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2020, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2019. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 258 çështje me objekt gjykimin e themelit dhe administrative penale dhe 122 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 81 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 63 çështje themeli e administrative penale dhe 18 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Çështjet të përfunduara nga Prokurori Ludovik DODA vitit 2019

Viti 2019	Ankim Prokurori	Ankimtë Pandehuri etj.	Ankim Prok.+Pand.	Totali
Gjyk themeli dhe Administrative penale	57	177	2	236
Masa sigurimi	18	102	2	122
Të mbartura 2018	6	15	1	22
Totali	81	294	5	380

Nga 81 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqësuar nga ana e prokurorit Ludovik Dodaj gjatë vitit 2019, rezulton se janë përkrahur 59 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 3 raste. Në 11 raste të tjera që i përkasin kryesisht çështjeve administrative penale me objekt kundërshtim vendimi pushimi ose mosfillimi procedimi penal, ankimet e prokurorëve të rrethit nuk janë përkrahur nga ky prokuror duke vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit për vazhdimin e hetimeve. Në 3 raste sënjë gjyqësore është zhvilluar pa praninë e prokurorit në dhomë këshillimi. Është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 5 raste që i përkasin 4 raste ankimeve të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 1 rast Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavaje. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi rastet janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 36 raste të cilat i përkasin 20 ankime të prokurorisë Durrës, 14 ankime të prokurorisë Elbasan dhe 2 ankime të Prokurorisë Kavajë. Sipas objektit rezulton se janë pranuar nga gjykata 30 ankime për çështje themeli dhe çështje administrative penale dhe 6 ankime për masë sigurimi.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 18 çështje të cilat sipas rrethëve gjyqësore i përkasin; 10 Rekurse për rrethit gjyqësor

Durrës, 7 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 1 rekurs rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 15 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 2 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 1 rast për vendime administrative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Moisi Duda. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2019, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 408 çështjeve penale, nga të cilat 15 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2018. Nuk ka përfunduar gjykimin për 22 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2020, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2019. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 275 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe administrative penale dhe 133 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 92 çështje, respektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 67 çështje themeli e administrative penale dhe 25 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Çështjet të përfunduara nga Prokurori Moisi DUDA vitit 2019

Viti 2019	Ankim Prokurori	Ankim të Pandehuri etj.	Ankim Prok.+Pand.	Totali
Gjyk themeli, Administrative penale	63	183	14	260
Masa sigurimi	25	106	2	133
Të mbartura 2018	4	11	0	15
Totali	92	300	16	408

Nga 92 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqësuar nga ana e prokurorit Moisi Duda gjatë vitit 2019, rezulton se janë përkrahur 65 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 3 raste, mosprërkrahje ankimi të prokurorit në 15 çështje që i përkasin kryesisht çështjeve administrative penale me objekt kundërshtim vendimi pushimi ose mosfillimi procedimi penal. Për keto raste prokurori i apelit nuk e ka përkrahur prokurorin e rrethit pasi ka vlerësuar te drejte vendimin e gjyqes se rrethit për vazhdimin e hetimeve. Në 5 çështje seanca gjyqësore është zhvilluar pa praninë e prokurorit në dhomë keshillimi. Për 4 raste është deklaruar heqja dorë nga apeli i prokurorit të shkallës parë që i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi janë diskutuar me prokurorët e prokurorisë së shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 32 raste të cilat i përkasin 16 ankime të prokurorisë Durrës si dhe 13 ankime

të prokurorisë Elbasan dhe 3 ankime Prokurorise se Rrethit Kavaje. Sipas objektit rezulton se janë pranuar nga gjykata 26 ankime për çështje themeli e administrative penale dhe 6 ankime për masë sigurimi. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 44 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 20 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 18 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 6 rekurse rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 26 raste për çështje me objekt themelin, 10 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 8 raste për vendime administrative penale. Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Afërdita Ndoi. Nga kjo prokurore gjatë periudhës Maj - Dhjetor 2019, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 247 çështjeve penale. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 166 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe administrative penale dhe 81 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga kjo prokurore është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 45 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 34 çështje themeli dhe administrative penale dhe 11 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Çështjet të përfunduara nga Prokurorja Afërdita Ndoi gjatë vitit 2019.

Viti 2019	Ankim Prokurori	Ankimtë Pandehuri etj.	Ankim Prok.+Pand.	Totali
Gjyk themeli dhe Administrative penale	34	125	7	166
Masa sigurimi	11	70	0	81
Totali	45	195	7	247

Nga 45 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqësuar nga ana e prokurores Afërdita Ndoi, gjatë vitit 2019, rezulton se janë përkrahur 37 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 2 raste. Mosërkrahje e ankimit të prokurorit në 4 raste që i përkasin kryesisht çështjeve administrativo penale me objekt kundërshtim vendimi pushimi ose mosfillimi procedimi penal. Për keto raste prokurori i apelit nuk e ka përkrahur prokurorin e rrethit pasi ka vlerësuar te drejte vendimin e gjykatës se rrethit për vazhdimin e hetimeve. Është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 2 raste. Heqjet dorë në përgjithësi janë diskutuar me prokurorët e prokurorisë së shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e saj bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 17 raste të cilat i përkasin 10 ankime të prokurorisë Durrës, 5 ankime të prokurorisë Elbasan si

dhe 2 ankime të prokurorisë rrethit Kavajë. Sipas objektit rezulton se janë pranuar nga gjykata 10 ankime për çështje themeli dhe çështje administrative penale dhe 7 ankime për masë sigurimi.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 12 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 5 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 6 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 1 rekurs rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 6 raste për çështje me objekt themelin, 3 çështje me objekt vlefësim e caktim mase sigurimi si dhe 3 raste për vendime administrative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Ferdinand Elezi. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-prill të vitit 2019, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 56 çështjeve penale, nga të cilat 6 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2018. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 40 çështje me objekt gjykimin e themelit dhe çështje administrative penale dhe 16 çështje me objekt vlefësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 5 çështje, respektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 4 çështje themeli dhe administrative penale dhe 1 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vlefësim e caktim mase sigurimi.

Çështjet të përfaqësura nga Prokurori Ferdinand ELEZI në periudhën Janar 2019 – Prill 2019

Viti 2019	Ankim Prokurori	Ankim i të Pandehurit, etj.	Ankim Prokuror +Pandehur	Totali
Gjyk themeli e Administrative penale	4	30	0	34
Masa sigurimi	1	15	0	16
Të mbartura nga 2018	0	6	0	6
Totali	5	51	0	56

Nga 5 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqësuar nga ana e prokurorit Ferdinand Elezi gjatë periudhës janar – prill 2019, rezulton se janë përkrahur 2 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi për shkak amnistie në 1 rast si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 2 raste. Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 5 raste të cilat i përkasin 4 ankime të prokurorisë

Durrës, 1 ankim të prokurorisë Elbasan. Sipas objektit rezulton se janë pranuar nga gjykata 4 ankime për çështje themeli, dhe administrative penale dhe 1 ankim për masë sigurimi.

Puna e prokurorisë së Apelit Durrës në raport me zbatimin e rekomandimeve dhe prioriteteve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit

Në punën e kësaj prokurorie, janë mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet dhe prioritetet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, për të cilën kemi informuar në mënyrë të veçantë më datë 05.02.2020 Prokurorin e Përgjithshëm, për krimin kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe krimeve me natyrë gjinore dhe kundër të miturve.

Nga të dhënat, rezulton se si qëndrimi i prokurorëve të shkallës së parë dhe ai i apelit ka qenë konsekuent si në ngritjen e akuzave, ashtu edhe në kërkesat përpara gjykatës për caktimin e masave të sigurimit, përse i përket krimin të korrupsionit ku pothuajse në shumë raste të kësaj natyre, është kërkuar masa e sigurimit ajo e “arrestit në burg” si dhe kërkesat për masat e dënimit kanë qenë në përputhje me ligjin dhe në raste shumë të rralla janë kërkuar dënime alternative.

E njëjta situatë paraqitet edhe për krimin e organizuar, ku numri më i madh i çështjeve i përket nenit 283 të K.Penal me 23 çështje. Edhe në këtë natyrë veprash penale, nga ana e prokurorëve të rrethit dhe të apelit është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe lloji i dënimit “me burgim”, ndërsa dënimi alternativ është kërkuar në shumë pak raste.

Sa i përket kriminalitetit me natyrë gjinore, numri më i madh i çështjeve i përket veprës penale të “Dhunës në familje” me 55 çështje gjithsej. Edhe për këtë lloj vepre penale, prokurorët në raste shumë të rralla kanë kërkuar masa sigurimi të ndryshme nga ajo e “arrestit në burg” apo dënime alternative. Kur dhuna është ushtruar ndaj grave dhe fëmijëve, nuk është toleruar në aspektin masës së sigurimit apo llojit të dënimit.

Krahas kësaj në punën e prokurorëve të apelit, për vepra penale me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore, është mbajtur në konsideratë rekomandimi i Këshillit të Europës për caktimin e masave të sigurimit më të lehta se ajo e “arrestit në burg” si dhe aplikimin e dënimit me gjobë si dhe aplikimin e dënimeve alternative sipas neneve 59 dhe 63 të K.Penal.

Për vitin 2019, në punën e prokurorëve të apelit Durrës, krahas dispozitave materiale e procedurale janë mbajtur në vlerësim edhe ndryshimet e fundit të ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, ku është vlerësuar në princip ndryshim thelbësor decentralizimi i organit të prokurorisë si dhe ndryshimet e kodit të procedurës penale të vitit 2017 ku dhe në këto ndryshime evidentojmë futjen për herë të parë si subjekt procedural gjyqtarin paraprak në procesin e hetimit.

Për shkak dhe të dinamikës së gjerë të këtyre ndryshimeve si dhe rritjes së numrit të procedimeve penale dhe të mungesës së unifikimit të praktikës nga Gjykata e Lartë, hera herës në punën tonë kemi hasur vështirësi të interpretimit të dispozitave të reja. Mendojmë se nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për këtë pjesë, mund të nxirren udhëzime dhe komente në lidhje me zbatimin e tyre në praktikë.

Për shkak të procesit të rivlerësimit, puna e kësaj prokurorie nga prilli 2019, është ushtruar me 2 prokurorë dhe 1 prokuror të komanduar, duke përbërur një volum dhe ngarkesë pune të lartë. Edhe për këtë pikë, mendojmë se duhet të studiohet në tërësi ngarkesa e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për të përcaktuar numrin e prokurorëve me ngarkesë normale për të mosçenuar cilësinë në ushtrimin e ndjekjes penale.

Një rëndësi të veçantë në ndihmë të prokurorëve ka edhe administrata, e cila mendoj që po të pësojë ndryshim në emërtimin e funksionit nga “sekretar” në “ndihmës pranë prokurorëve”,

bëhet më efçente duke lehtësuar në këtë mënyrë punën e prokurorit në dinamikën që paraqesin çështjet në hetim dhe gjykim.

Pavarësisht se pregatitja e kësaj analize, është zhvilluar në kushte të ndryshme nga vitet e mëparshme, për shkak të dëmtimeve që ka pësuar godina e gjykatës së apelit Durrës nga tërmeti i 26 nëntorit dhe transferimit në zyrat e Prokurorisë së Rrethit Kavajë, situatë e cila ka krijuar vështirësi jo vetëm në menaxhimin e kohës për ndjekjen e gjykimeve të cilat zhvillohen në Gjykatën e rrethit Kavajë që është në distancë të konsiderueshme nga godina e Prokurorisë Kavajë, por edhe në pasqyrimin e punës së kësaj prokurorie për shkak të dokumentacionit që ndodhet i arkivuar në godinën e dëmtuar, jemi munduar që të prekim të detajuar në shifra të sakta veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Durrës përgjatë vitit 2019.

DREJTUESI I PROKURORISË APELIT

Ludovik DODAJ



11

2